

Si i ndihmoj unë fëmijës tim, të fitoj kënaqësi gjatë leximit? Një përmbledhje idesh për prindër

Përmbledhje e shkurtër idesh, duke ju falënderuar inspektorat të shkollës Kantoni Basel-Land

Mësimi për të lexuar është proces i gjatë, gjë që ju si prindër te fëmijët e juaj mundeni aktivisht dhe me ndikim të plotë ta mbështetni dhe ndihmoni.

Të diturit për të lexuar mirë, e ndihmon shumë suksesin në shkollë të fëmijës tuaj.

E kur gjuha e nënës nuk është gjermanishtja?

Ju mund ta ndihmoni fëmijën tuaj, poashtu edhe nëse nuk dini apo nuk flisni mirë gjermanisht. E rëndësishme është, që fëmijën tuaj ta ndihmoni të flas dhe të lexoj në gjuhën të cilën ju e flisni rrjedhshëm. Kjo është normalisht gjuha juaj amëtare. Nëse një fëmijë e zotëron gjithanshëm gjuhën e nënës, është shumë më e lehtë, ta zotëroj ndërrimin në gjuhën gjermane.

7 sugjerimet në radhë ju udhëzojnë ju, në ç`mënyrë mund ta ndihmoni fëmijën tuaj më së miri.

Sugjerimi 1: Flisni me fëmijën tuaj

Gjuha gojore është themel për lexim. Me të dëgjuar dhe të folur fëmija juaj do të afrohet te gjuha. Nëpërmes të folurit dhe këndimit do t'i afrohet fëmijës tingulli i gjuhës. Kjo i ndihmon fëmijës tuaj ta fitoj aftësin e të lexuarit. Pikat e radhës ju tregojnë ju, se si mundeni fëmijën tuaj ta ndihmoni në gjuhën gojore:

- Tregoni në familje tregime për vetveten, për gjyshërit dhe të njohurit.
- Flisni me fëmijën tuaj për gjëra, që ju i bëni dhe për atë çka mendoni.
- Bëni fëmijës tuaj pyetje.
- Nxisni fëmijën tuaj të tregoj se çka ndjenë dhe medon.
- Kërkoni fëmijës tuaj që tu tregoj ju, për përjetimet e tij gjatë ditës.
- Jepni fëmijës tuaj kohë gjatë të folurit. Lejeni që t'i gjejë vetë fjalët për tu shprehur.
- Mësoni me fëmijën rimime dhe vjersha me numrim. Këndoni me te këngë fëmijësh.

Sugjerimi 2: Bëjeni leximin kënaqësi

Leximi dhe paraleximi mundet gjithë familjen ta argëtoj. Sugjerimet e radhës e ndihmojnë fëmijën tuaj gjatë leximit.

- Lexoni tregimet e dashura të fëmijës tuaj aq shpesh sa ai kërkon. Zgjedhni librat të cilat fëmijën tuaj e argëtojnë. Lexoni tregime, pjesë që përsëriten, këto e trimërojnë fëmijën tuaj të bashkëlexoj.
- Tregoni gjatë leximit edhe fjalët. Kjo i ndihmon fëmijës tuaj të krijoj një lidhje në mes fjalëve të folura dhe të shkruara. Përdorni tekste të ndryshme: Tregime, vjersha, artikuj nga gazetatat dhe revistat, stripat.
- Nëse fëmija juaj në mëngjesin tjetër mund të flejë, caktoni parambrëmjen si mbrëmje për lexim. Lejoni fëmijës tuaj atëherë të rrijë më gjatë zgjuar, apo të lexoj në shtrat.
- Trimëroni të afërmit dhe të njohurit, fëmijës tuaj t'i dhurojnë libra.
- Vizitoni me fëmijën tuaj një bibliotekë.
- Parapaguani për fëmijën tuaj një revistë për të rinjë.

Sugjerimi 3: Lexoni për ditë

Fëmijët i duan ritualet. Leximi është diçka, për të cilin ju dhe fëmija juaj s' bashku mund të gëzoheni. Nëse ju merrni kohë për këtë, i tregoni fëmijës tuaj se leximi është i rëndësishëm dhe sjell kënaqësi.

- Filloni që herët, fëmijës tuaj t'i paralexoni.
- Bëni mundësisht përditë një kohë të caktuar, ku ju s' bashku mund të koncentrohni me lexim të përbashkët.
- Bëni një kënd të rahatshëm për të lexuar.
- Zgjedhni libra të ndryshëm.
- Paralexoni ngadalë, që fëmija juaj ta përfytyroj tregimin me pamje.
- Kultivoni leximin tutje, edhe atëherë kur fëmija juaj di të lexoj. Ju provoni s' bashku gjëra të reja nga bota, dhe mundeni për magjinë e leximit s' bashku të gëzoheni.

Sugjerimi 4: Bëhuni për fëmijën tuaj shembull

Si prindë jeni ju një shembull i rëndësishëm për fëmijën tuaj. Kur ai e sheh se ju vetë lexoni për kënaqësi apo për tu informuar, ai mund ta kuptoj se të lexuarit është një veprimtari e vlefshme.

- Lexoni receta, shkrime në paketimie, doracakë etj. me zë.
- Lexoni me fëmijën tuaj shenjat e komunikacionit, tabelat udhëzuese, emrat e shitoreve dhe të restoranteve.
- Përdorni libra kuzhine, libër telefoni, atlas, fjalor, për të kapur informacione.
- Lexoni me fëmijën tuaj kartela, letëra apo e-mail nga shokët dhe të afërmit.

Sugjerimi 5: Flisni për libra

Të flisni për libra është poaq e rëndësishme si të lexoni. Fëmija kështu krijon lidhje me përjetimet e veta. Dhe e ka mundësin që fjalorin e tij ta zgjeroj me fjalë të reja dhe shprehje.

- Flisni me fëmijën tuaj, cilat libra do t'i lexonte me dëshirë.
- Tregoni për librin e dashur nga fëmijëria e juaj.
- Trimëroni fëmijën tuaj gjatë leximit të një vjershe, të gjej se cila fjalë rimëuse, mund të vij në radhë.
- Trimëroni fëmijën tuaj, të bëjë pyetje gjatë leximit të një tregimi.
- Trimëroni fëmijën tuaj, që të bëjë edhe kritik. A është ai i pajtimit me mendimin e një autori apo autorje?
- Ndërpreni leximin duke bërë pyetje për tekstin.
- Jepni fëmijës tuaj kohë që të mendoj për një tregim. Shtroni pas disa ditëve prapë pyetje në lidhje me tregimin.
- Bisedoni me fëmijën pas leximit për tregimin. Kështu e shihni ju a e ka kuptuar fëmija juaj tekstin.

Sugjerimi 6: Dëgjojeni fëmion tuaj gjatë leximit

Nëse ju e dëgjoni, fëmija juaj e ka mundësinë të ushtroj dhe ta përmirësojë leximin. Reagimi dhe vëmendja e juaj janë të rëndësishme.

- Tregoni fëmijës tuaj, që tregimet e lexura të krijojnë kënaqësi, tregoni interesim dhe bëni pyetje në lidhje me këtë.
- Jepni fëmijës tuaj kohë që fjalët e vështira t'i shqiptoj dhe t'i lexoj vetë.
- Kujdesuni që gjatë leximit të mos pengohet.
- Kujdesuni që fëmija juaj të mos zgjedhë tekste shumë të vështira.
- Ndërrrohuni me fëmijën tuaj gjatë leximit dhe përpiquni të lexoni diçka s' bashku.

Sugjerimi 7: Çmoni përpjekjet e fëmijës tuaj

Për të mësuar të lexosh duhet kohë, shumë ushtrime, dhe përkrahje nga mësuesit dhe prindërit.

- Lavdëroni fëmijën tuaj kur lexon.
- Ndhmoni fëmijës tuaj t'i gjej librat e duhura p.sh. në bibliotekë.

Ju nuk jeni vetëm

Ju nuk jeni vetëm, që fëmijën tuaj gjatë mësimit për të lexuar ta ndihmoni. Edhe motra e vëllau apo anëtarët e tjerë të familjes mund të ndihmojnë. Flisni edhe me mësuesit e fëmijës tuaj, se si mundeni ta ndihmoni fëmijën tuaj. Interesimi juaj i ndihmon fëmijës tuaj që të bëjë sukses të mirë në shkollë.